



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



ZGJEDHJET PER KUVENDIN E
OFK-SE 2026

APLIKACIONI PËR KANDIDIM PËR ANËTARË TË KUVENDIT TË OFK- së

**NJËSIA ZGJEDHORE NË
TË CILËN KANDIDONI**

TË DHËNAT E KANDIDATIT/ES PËR ANËTARË TË KUVENDIT TË OFK-së

Emri		Data e lindjes	
Mbiemri		Nr. Licences	RKS-
Nr. kontaktues		E-mail	

** Me nënshkrimin tim deklaroj se të gjitha të dhënat e paraqitura në këtë aplikacion janë të sakta dhe të vërteta, si dhe mbaj përgjegjësi ligjore për saktësinë dhe vërtetësinë e tyre. Gjithashtu, deklaroj se jam i/e njoftuar me procedurën, rregullat zgjedhore dhe rregullat e sjelljes zgjedhore, të cilat janë bashkëngjitur me këtë aplikacion, si dhe me pasojat që mund të rrjedhin nga mosrespektimi i tyre, përfshirë iniciimin e procedurave disiplinore, penale dhe/ose diskualifikimin nga gara zgjedhore, sipas rregullave të përcaktuara nga KQZ-ja.*

Nënshkrimi i kandidatit/es* _____

TË DHËNAT MBI MBËSHTETËSIT

Mbështetësit duhet të jenë nga njësia e kandidatit

	Emri Mbiemri	Nr. Personal	Nënshkrimi*	Nr. Licencës	Data e nënshkrimit
1.					
2.					
3.					
4.					
5.					

***Deklarata e mbështetësve të kandidatit/es**

**Deklaroj se mbështetjen për kandidatin/en e kam dhënë me vullnetin tim të lirë, pa iu nënshtruar asnjë forme presioni, ndikimi të padrejtë, kërcënimi apo kushtëzimi. Gjithashtu, deklaroj se kam mbështetur vetëm këtë kandidat/e për anëtar/e të Kuvendit të OFK-së dhe se jam i/e njoftuar me rregullat zgjedhore dhe rregullat e sjelljes zgjedhore të përcaktuara nga KQZ-ja, si dhe me pasojat që rrjedhin nga mosrespektimi i tyre, përfshirë masat disiplinore, iniciimin e procedurave penale dhe/ose diskualifikimin nga procesi zgjedhor.*

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke u bazuar në nenin 19 të Statutit të OFK-së nr. 134, të datës 04/06/2024, dhe në nenin 31 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së nr. 275, të datës 30/12/2024, me qëllim të informimit publik të anëtarëve dhe kandidatëve për anëtarë të Kuvendit të OFK-së, nxjerr këtë:

NJOFTIM PËR KRITERET DHE DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR KANDIDIM

Kandidati duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të jetë në listën votuese të certifikuar nga KQZ në njësinë ku kandidon;
2. Të ketë mbështetjen e së paku 5 anëtarëve të njësisë përkatëse;
 - Një anëtar/e mund të mbështesë vetëm një (1) kandidat/e;
 - Kandidati nuk mund ta nënshkruajë për kandidaturën e tij/saj;
3. Të mos jetë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepra penale që lidhen me keqpërdorimin e detyrës zyrtare apo kundër shëndetit publik;
4. Të mos i jetë shqiptuar masa e tërheqjes së licencës për 3 apo më shumë vite gjatë 5 viteve të fundit.
5. Të mos jetë anëtar i KQZ-së apo KNJZ-së.
6. Kandidati për anëtar të Kuvendit të OFK-së nuk mund të ketë ushtruar dy mandate të njëpasnjëshme në Kuvendin e OFK-së.

Dokumentet e nevojshme:

1. Formulari i plotësuar i kandidimit, i cili merret në ueb-faqen zyrtare të OFK-së;
2. Certifikata mbi gjendjen penale, e lëshuar përmes platformës e-Kosova;
3. Vërtetimi etik nuk kërkohet, pasi KQZ është njoftuar zyrtarisht se nuk ka masa të tilla të shqiptuara.

Afati dhe mënyra e dorëzimit:

Kandidaturat dorëzohen fizikisht në zyrat e OFK-së, nga data **04 Maj deri më 14 Maj 2026**, në orarin **08:30 – 15:00**.

Kontakt:

Për informata shtesë: kqz.ofk1@gmail.com, apo shkruani ne viber 048 57 22 22

NJOFTIM

për rregullat e sjelljes zgjedhore gjatë periudhës zgjedhore

Të gjithë kandidatët, mbështetësit e tyre, votuesit dhe vëzhguesit njoftohen se gjatë periudhës zgjedhore janë të obliguar të respektojnë rregullat dhe standardet e sjelljes zgjedhore, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i OFK-së me vendimin e datës 30/04/2026 i qasëshëm në web faqen e OFK-së.

Gjatë periudhës së kandidimit, mbledhjes së nënshkrimeve mbështetëse, fushatës zgjedhore dhe ditës së votimit, të gjithë pjesëmarrësit në proces duhet të veprojnë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, barazisë, transparencës, paanshmërisë dhe integritetit të procesit zgjedhor.

Ndalohet çdo veprim që cenon lirinë e kandidimit, të votimit, fshehtësinë e votës apo rregullsinë e procesit zgjedhor. Në veçanti, ndalohet ushtrimi i presionit, ndikimit të padrejtë, kërcënimit apo kushtëzimit ndaj anëtarëve; sigurimi i nënshkrimeve mbështetëse përmes mashtrimit, detyrimit apo premtimeve të përfitimeve; pengimi i punës së KQZ-së dhe KNJZ-ve; qëndrimi pa autorizim në qendrën e votimit; ofrimi i shpërblimeve apo përfitimeve për sigurimin e votës ose mbështetjes; kërcënim i kandidatëve, votuesve apo vëzhguesve; votimi më shumë se një herë apo votimi në emër të personit tjetër; përdorimi i gjuhës fyese, kërcënuese apo nxitëse të urrejtjes; ndërhyrja në votim, numërim apo administrim të materialit zgjedhor, si dhe çdo veprim tjetër që cenon rregullsinë ose rezultatin e procesit zgjedhor.

Vëzhguesit kanë të drejtë të përcjellin procesin zgjedhor vetëm në përputhje me autorizimin e dhënë. Atyre u ndalohet ndërhyrja në proces, ndikimi të votuesit apo pengimi i mbarëvajtjes së votimit.

Çdo pretendim për shkelje të këtyre rregullave duhet të paraqitet në KQZ, jo më vonë se 24 orë nga momenti i pretendimit për shkelje. Ankesa duhet të përmbajë përshkrimin e shkeljes së pretenduar dhe dëshmitë përkatëse, kur ato ekzistojnë.

Në rast të konstatimit të shkeljeve, KQZ-ja mund të ndërmarrë dhe të iniciojë masa përkatëse, përfshirë masa etike dhe disiplinore, diskualifikimin e kandidatit nga procesi zgjedhor, si dhe iniciimin e procedurave përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Ky njoftim i bashkëngjitet formularit të kandidimit dhe shërben për informimin e kandidatëve dhe mbështetësve lidhur me rregullat e sjelljes zgjedhore gjatë periudhës zgjedhore.